



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3642 Prot.

Rrogozhinë, më 04 .09.2025

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Martë datë 09 .09.2025 ora 14:00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.8, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 19.08.2025.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2025 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë”.
- 6- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, akademia e trajnimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (Talga)”.
- 7- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore Bashkia Rrogozhinë”.
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për Përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Mbrojtjen Civile”.
- 9- Raportim nga drejtoria e financës mbi realizimin e treguesve ekonomike-financiare për 6-mujorin e I-rë të vitit 2025 në Bashkinë Rrogozhinë.
Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 19.08.2025.
- 10- Informacion nga drejtoria e politikave urbane për punën e bërë në drejtim të aplikimeve të lejeve on - line, projekteve të reja, procesin e legalizimit dhe evidentimin e problemeve të kadastrës dhe pronave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Shqyrtohet i njëjti material i vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 19.08.2025

11- Informacion mbi punën e bërë nga Sektori i Pyjeve dhe përmisimin e shërbimeve dhe veprimtarisë që ofron në këtë fushë.

12- Të ndryshme.

-Kërkesë nga poeti z.Hekuran Dedej.

Shqyrtohet e njëjta kërkesë e vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 15.07.2025.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 08.09.2025 ora 10 : 00^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit, me këtë përbërje : Alime Hoxha - Kryetare, Merilin Saraçi - Zëvendëskryetare, Enver Memolla -Anëtar, Gëzime Met-hasani- Anëtare, Indrit Dedej -Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 08.09.2025 ora 10 : 30^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave, me këtë përbërje : Lulzim Hasa - Kryetar, , Fatmira Thartori - Anëtare, Altin Tosku - Anëtar, Hekuran Xhani - Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Hënë datë 08.09.2025 ora 11 : 00^{oo}, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit, me këtë përbërje : Sokol Gosa - Kryetar, Erind Tosku - Zëvendëskryetar, Renato Kalemi - Anëtar, Fatmira Thartori - Anëtare, Besnike Coraj - Anëtare.

Shënim : Cilido komision tjetër që e konsideron të arsyeshme për t'u mbledhur dhe për të shqyrtuar një apo disa pika të rendit të ditës është i lutur të kordinojë me Sekretarin e Këshillit Bashkiak.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI